

Përshëndetje,

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe e Rinisë dhe INSTAT, në bashkëpunim me Programin Për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Qeverinë Zvicerane, do prezantojnë sot dy publikime të reja; profili i Personave me Aftësi të kufizuar dhe Popullsia Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri.

Qëllimi i këtyre dy publikimeve është të kontribuojë në evidentimin e situatës sociale dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuar dhe grupeve vulnerabël në Shqipëri siç janë popullsia rome dhe egjiptiane. Këto publikime janë bazuar në të dhënat e Censur 2011 dhe Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2012.

Aftësia e kufizuar dhe vulnerabiliteti janë fenomene dinamike dhe të lidhura në mënyrë komplekse duke patur shumë faktorë të cilat ndikojnë tek njëri-tjetri.

Në vendet e zhvilluara, kërkimet në këtë fushë kanë treguar se personat me aftësi të kufizuara përballen me arritje relativisht më të ulëta në nivelin arsimor, shkallë më të ulët punësimi dhe shkallë papunësie më të lartë, kushte jetese më të vështira dhe shkallë më të lartë varfërie.

Nga ana tjetër, përsa i përket vendeve në zhvillim, studimet nxjerrin në pah se individët me aftësi të kufizuara shpesh janë në disavantazh ekonomik për sa i përket punësimit dhe nivelit arsimor të arritur, ndërsa në nivel familjeje, faktet janë të përziera, edhe pse kërkimet janë më të kufizuara në këto vende.

Disa nga gjetjet e publikimit të profilit të personave me aftësi të kufizuar janë: Personat me aftësi të kufizuar përbëjnë 6,2 % të popullsisë dhe prevalencën më të lartë ndër to e ka vështirësia në lëvizje me 3,7%. Ndërsa dëgjimi dhe komunikimi përbëjnë vetëm 1,7 dhe 1,5 përqind të prevalencës për personat me aftësi të kufizuar. Përsa i përket shpërndarjes gjeografike, rezultatet tregojnë se Tirana ka prevalencën më të ulët (më pak se 5%) dhe Gjirokastra ka prevalencën më të lartë me 8%.

Personat me aftësi të kufizuar në moshë pune kanë 2 herë më tepër gjasa të jenë jashtë forcës së punës sesa personat pa aftësi të kufizuar.

Ndërsa publikimi i Profilit për Popullsinë Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri analizon profilin social-demografik të këtyre dy komuniteteve, nivelin e tyre arsimor, situatën në drejtim të punësimit, strehimit, shëndetësisë dhe dimensione të tjera lidhur me kushtet e tyre të jetesës.

Specifikat demografike të popullsisë rome dhe egjiptiane dallohen dukshëm në procesin e formimit të familjeve. Martesa dhe prindërimi i hershëm janë diçka e zakonshme: në moshën 20 vjeç, 60% e femrave rome janë të martuara (dy herë më shumë sesa femrat e grupeve të tjera etnike) dhe 43% e vajzave të moshës 18 vjeç kanë lindur një fëmijë.

Një tregues shumë domethënës është përqindja e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm. Braktisja është e rrallë përpara moshës 10 vjeç (më pak se 3% dhe më e lartë për vajzat sesa për djemtë), por është më e konsiderueshme në fillim të ciklit të arsimit të detyrueshëm (9 vjeçar). Nga 43% të romëve (40% gra dhe 46% burra), të cilët kanë përfunduar një cikël të plotë të arsimit fillor, vetëm 21% e tyre ka përfunduar arsimin 9-vjeçar (18% gra dhe 23% burra).

Situata kritike në arsim çon në një gjendje akoma edhe më kritike në drejtim të tregut të punës. Më pak se çereku i secilit grup është i punësuar dhe pabarazia gjinore është befasuese: vetëm 15% e grave rome dhe 13% e grave egjiptiane janë të punësuar.

Panorama e gjendjes së romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri dëshmon për një dukuri të përjashtimi social, shkaqet e secilës duhen analizuar me tej. Profili i personave me aftësi të kufizuar dhe popullsisë rome dhe egjiptiane janë përpjekja e parë për të profilizuar këto grupe vulnerabël në Shqipëri dhe duhet të shërbejë për analiza më të thelluara në të ardhmen.

INSTAT ofron në çdo moment bashkëpunimin e tij për çdo institucion, organizatë apo akademikë për të qarqësuar më tej evidentimin e situatës së këtyre personave ose grupeve të tjera vulnerabël në vend, duke furnizuar me të dhëna apo duke ofruar bashkëpunim për analiza të mëtejshme.

Statisikat sociale janë një instrument mjaft i rëndësishëm për të kuptuar mirë gjendjen e shoqërisë sonë dhe INSTAT tashmë ka vendosur në dispozicion të gjithë të dhënat që disponon për tu lejuar çdokujt të kryejë analiza të mëtjeshme. Por, nga ana tjetër, ne jemi gjithashtu të interesuar dhe të gatshëm të kryejmë analiza apo studime të tjera për të pasuruar më tej panoramën e gjendjes sociale të shoqërisë shqiptare.

Falenderoj Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe e Rinisë, Programin Për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Qeverinë Zvicerane për bashkëpunimin e frytshëm në nxjerrjen e këtyre dy publikimeve dhe të tjerave që kanë realizuar me INSTAT të cilat do ti shërbejnë politikëbërësve, akademikëve si dhe shoqërisë civile.